



**KTV**  
**Flaka SURROI**  
**Drejtoreshë**  
**Prishtinë**

**Rasti Nr. 2018/174**  
**Ref:1812/1378/KPM/mf**

### VENDIM

**Lidhur me Rastin Nr. 2018/174 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për  
KTV (“Palë Përgjegjëse”)**

---

#### Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) me datën 28 maj 2013 ka nxjerrë Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale KPM 2013/01. Me këtë rregullore është përcaktuar mënyra e kategorizimit, sinjalizimit dhe zgjedhjes së kohës së transmetimit të programeve të cilat mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin fizik, mental, emocional dhe moral të fëmijëve dhe të miturve.
2. KPM prej datës 2 deri me 5 korrik 2018 ka bërë monitorimin e programeve të Palës Përgjegjëse për të vlerësuar pajtueshmërinë me Rregulloren KPM 2013/01.
3. KPM në bazë të Raportit të monitorimit të datës 8 gusht 2018 ka gjetur se Pala Përgjegjëse gjatë transmetimit të serialit “*Cennet in*” nuk i ka përdorur piktogramet dhe shenjat e përcaktuara me Rregulloren KPM 2013/01, duke vepruar kështu në kundërshtim me Rregulloren KPM 2013/01.
4. KPM, pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 17 gusht 2018 i ka dërguar Palës Përgjegjëse Njoftim për Shkelje me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe i ka kërkuar të veprojë në pajtim me Rregulloren KPM-2013/01, në të kundërtën do t’i rekomandojë Komisionit të KPM-së të ndërmarrë masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse në pajtim me nenin 30 të Ligjit të KPM-së.
5. KPM ka bërë edhe një monitorim të dytë për të parë nëse pas Njoftimit për shkelje Pala Përgjegjëse ka ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2013/01, dhe bazuar në Raportin e monitorimit të datës 5 dhjetor 2018 është gjetur se Pala Përgjegjëse ka vazhduar të jetë në shkelje të Rregullores KPM-2013/01.

## Analiza Ligjore

6. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 7 Shenjat dhe piktogramet, paragrafi 1 dhe 2, të Rregullores KPM-2013/01.

Neni 7, paragrafi 1, i Rregullores KPM-2013/01, përcakton se:

*“Subjektet transmetuese do të përdorin piktogramet të paraqitura në Aneksin I të kësaj Rregulloreje.”*

Neni 7, paragrafi 2, i Rregullores KPM-2013/01, përcakton se:

*“Shenjat e vërejtjes për Kategoritë e përcaktuara me këtë nen janë të detyrueshme për të gjitha programet e përcaktuara në nenin 5”.*

Komisioni në bazë të raporteve të monitorimit ka gjetur se Pala Përgjegjëse gjatë transmetimit të filmave “Solace” dhe “Momentum”, të zhanreve triller, aksion dhe krim, nuk i ka përdorë piktogramet e parapara si dhe shenjat e përcaktuara me Rregulloren KPM-2013/01.

7. Komisioni ka gjetur se Pala Përgjegjëse edhe pas Njoftimit për shkelje të dërguar nga KPM në të cilin i është kërkuar që të veprojë në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2013/01, ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me Rregulloren KPM-2013/01.
8. Komisioni duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 7 paragrafi 1 dhe 2, të Rregullores KPM-2013/01.

## Vendim

9. Obligohet Pala Përgjegjëse që në afat prej dhjetë (10) ditësh pas pranimit të këtij Vendimi, filmat dhe serialet të cilat i transmeton, t'i identifikojë me simbolin përkatës vizual gjatë tërë kohëzgjatjes së tyre sipas kategorizimit të programeve të përcaktuara me Rregulloren KPM-2013/01;
10. Obligohet Pala Përgjegjëse që, duke u bazuar në nenin 3 paragrafi 5 të Rregullores KPM-2013/01, të nxjerrë Kodin Praktik në të cilin do të përcaktojnë standardet vetërregulluese për transmetimin e programeve që mund të kenë ndikim të dëmshëm tek fëmijët dhe të miturit, dhe këtë Kod të miratuar ta sjellë në KPM brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të këtij Vendimi;
11. Pala Përgjegjëse sanksionohet me Vërejtje, në pajtim me nenin 30, paragrafi 1 të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 7, paragrafi 1 dhe 2, të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale KPM 2013/01.

## E drejta për Ankesë

12. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i Vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
13. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

  
Muja FERATI  
Kryetar



27.12.2018  
Datë